



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Datë 28.01.2022

Prot.49 (dyzetëetenëntë)

Protokoll nr. 49

I mbajtur sot më datë 28.01.2022, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

- 1.Hapja e mbledhjes (korumi,miratimi i rendit të ditës,vendimet e mbledhjes së kaluar);
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.12.2021;
- 3.P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2021”;
- 4.P-V “Për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionin për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit”;
- 5.P-V “Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Illirjan Galla, magazina e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit”;
- 6.P-V “Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Arif Myftarago, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit”;
- 7.P-V “Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e pllakadës përkujtimore në vendin e quajtur “Kthesa e Pocestës” në përkujtim të të dënuarve me punë të detyruar për tharjen e kënetës së Maliqit”;
- 8.P-V “Për dhënien e miratimit të lidhjes së kontratës të huapërdorjes për pasurinë me nr.3/590, volumni 10, faqe 138, zona kadastrale 2573, midis bashkisë Maliq dhe Zyrës Arsimore Vendore Maliq”;
- 9.P-V “Për miratimin e bursave të arsimit parauniversitar dhe profesional të vitit shkollor 2021-2022”;
- 10.Diskutime të tjera.

**Këshilltarë në sallë:**

**Ornildi Demollari, Pranvera Begolli, File Qyrani, Kujtim Demollari, Floreta Zaçe, Klement Zere, Aldi Mullali, Valentina Pashollari, Aramando Dautllari, Llambi Kotmilloshi, Dritan Çami, Aleksandër Petriti, Fevri Sherfi, 12(dymbëdhjetë) këshilltarë**

**Këshilltarë online në platormën ZOOM:**

**Kristiana Jonusllari, Jonilda Koçllari, Fatjon Brahimllari, Ildir Limllari, Dorjan Zholi, Esemralda Spaho, Vasilika Trajko, Erinda Xhaferllari, Plator Çollaku, Kristina Malelli, Xhensila Nakoleci, 11 (njëmbëdhjetëdhjetë) këshilltarë.**



**Të pranishëm nga Administrata:**

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu;; Zv/Kryetari i Bashkisë z.Eridion Rustemi;  
Drejtor i Shërbimit Social z.Azem Nuhu; Përgjegjës i Emergjencave Civile z.Stiljan  
Belishta; Drejtori i Drejtorisë Jurudike dhe Prokurimve z.Genci Floqi.**

**Ornildi Demollari:** Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë këshilltarë, i nderuar nën/kryetar, të nderuar pjesëmarrës, ashtu sikur dhe jemi njoftuar, sot kemi mbledhjen e radhës së këshillit të bashkisë Maliq, me rend dite prej 12 pikash duke shtuar dhe ato që na u paraqitën me vonesë. Miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord me rendin e ditës?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së datës 24.12.2021,

- 1- Vendim nr.93, datë 24.12.2021;
- 2- Vendim nr.94, datë 24.12.2021;
- 3- Vendim nr.95, datë 24.12.2021;
- 4- Vendim nr.96, datë 24.12.2021;
- 5- Vendim nr.97, datë 24.12.2021;
- 6- Vendim nr.98, datë 24.12.2021;
- 7- Vendim nr.99, datë 24.12.2021;
- 8- Vendim nr.100, datë 24.12.2021;
- 9- Vendim nr.101, datë 24.12.2021;
- 10- Vendim nr.102, datë 24.12.2021;
- 11- Vendim nr.103, datë 24.12.2021;
- 12- Vendim nr.104, datë 24.12.2021;
- 13- Vendim nr.105, datë 24.12.2021;
- 14- Vendim nr.106, datë 24.12.2021.

Gjithsej dërgohen 12 vendime, lidhur me vendimin nr. 99, datë 24.12.2021, "Për shpërblim in e artistëve amatorë" nuk është konfirmuar nga ana e Prefektit të Qarkut pasi baza ligjore nuk përputhet me objektin e aktit. Faleminderit!

Miratojmë protokollin e mbedhjes së kaluar?

Kush është dakord me protokollin?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Fillojmë me rendin e ditës P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2021", kush e do fjalën?

**Pranvera Begolli:** Ta kalojmë!

**Ornildi Demollari:** Drejtor ke diçka për të shtuar?

E hedhim në votim?

Kush është dakord?

Kundra?



Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika e 4 rendit të ditës P-V “Për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionin për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit”, kush e do fjalën?

**Drejtor i Shërbimit Social z.Azem Nuhu:** Kriteret ne i miratojmë çdo fillim viti, janë kriteret për përfituesit e ndihmës ekonomike për bllok-ndihmën 6%, nëse ka ndonjë pikë tjetër që nuk e kemi vënë këtu mund ta shtojmë nëse ka propozime, por besoj se janë të përfshira të gjitha pikat, si familjet me gra kryefamiljare dhe ato me 5 anëtarë.

**Ornildi Demollari:** Bëhet fjalë për kriteret, ka ndonjë koment?

**Valentina Pashollari:** Ne i kemi miratuar çdo vit kriteret, ato të njëjtat janë?

**Drejtor i Shërbimit Social z.Azem Nuhu:** Është një procedurë që duhet ta bëjmë çdo vit.

**Ornildi Demollari:** Kolegët që na ndjekin online kanë diçka për kriteret?

E hedhim në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika e 5 rendit të ditës P-V “Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Illirjan Galla, magazina e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit”.

**Pranvera Begolli:** Kryetar ne e kemi kthyer këtë P-V më parë?

**Ornildi Demollari:** Po është e vërtetë para dy mbledhjesh.

**Pranvera Begolli:** Nuk e miratua për bazën ligjore se ishte vendosur dhe VKM-ja, aktualisht themi që është djegur magazina e z.Illirjan Gallo, por kush e konstatoi se në magazinë kishte dengje me jonxhë 170 copë dhe dengje kashte 50 copë? Për deri sa u dogjën të gjitha, kush e konstatoi që ishin kaq? Komisioni i pa dengjet duke u djegur? Apo magazina ishte totalisht e djegur?

**Ornildi Demollari:** Komisioni shikon çka mbetur nga djegia nga zjarri, jo para, se e di vetëm ai që i janë djegur.

**Pranvera Begolli:** Më duket vlerë e madhe nuk di çfarë të them, e diskutua dhe herën e kaluar, ai mund të thotë kisha dhe grurë dhe misër që mu dogj!

**Zv/Kryetari i Bashkisë z.Eridion Rustemi:** Përshëndetje! Znj.Pranvera ju keni të drejtë se pas një zjarri s’ dihet asgjë dhe kjo është normale, kjo vlera që është vendosur këtu mendoj që është e mjaftueshme dhe për atë pjesën e ndërtesës që është i dëmtuar zotërisë, besoj edhe sikur mos duket gjë nga pjesët e tjera që janë djegur, anëtarët e komisionit janë profesionistë të fushës, Petrit Yzo është agronomi i NJA Pirg dhe mendoj se do ketë qenë evidente pjesa e dengjeve dhe bazës materiale. Kështu që nuk besoj se ka vend për diskutim kjo pjesë.

**Pranvera Begolli:** P-V tjetër e ka vlerën 83.000 lekë që orendi të djegura, kurse te rasti i parë kemi dengje, kashtë e kemi në vlerën 93.500!



**Valentina Pashollari:** Me lejë Kryetar?

**Ornildi Demollari:** Po Vali!

**Valentina Pashollari:** Tani për vlerë thotë Pranvera, në tregun e lirë nuk e gjen dot me 500 lekë se ka shkuar me 100 lekë dhe dengjet me kashtë nuk i gjen dot me 150 lekë se kanë shkuar me 300 lekë, për vlerën nuk kam vëretje, bile për të nxjerrë një bagëti nga dimri duhen më shumë. Unë kam problem se mos na i kthejë Prefektura se ne asnjëherë nuk kemi financuar vlerë të plotë, do ishte më mirë ta shënonim “T”i jepet ndihmë për djegjen e magazinës”, si ja u kemi shënuar dhe në raste të tjera, pa specifikuar dengje, etj.

**Ornildi Demollari:** E kuptova por ne e kemi kthyer njëherë këtë P-V për këtë arsye. Specialistët e kanë sjellë përsër kështu, mendoj se duke qenë një çështje sensibil dhe e vuajne ata që ju ka rënë zjarri, unë ju ftoj si këshill ta votojmë P-V dhe nëse Prefektura nuk e konfirmon le të mbajnë përgjegjësi ata që e kanë hartuar.

**Valentina Pashollari:** Ata të mbajnë përgjegjësi dhe ta paguajnë ata vlerën, n.q.s. e kthen Prefektura. Ne kemi dhënë gjithmonë 50% të vlerës, P-V nuk ka ndryshuar fare nga hera e parë.

**Plator Çollaku:** Përshëndetje Kryetar! Mund të flas?

**Ornildi Demollari:** Po Plator!

**Plator Çollaku:** Unë jam dakord që njerëzit të ndihmohen 100%, por së pari duhet parë baza ligjore sa lejon që Këshilli Bashkiak të aprovojë në këto raste të tilla dhe n.q.s. jursiti e shikon bazën ligjore sa tolerohet dhe ky problem të zgjidhet dhe Prefektura mos e kthejë.

**Ornildi Demollari:** Ju mendoni ta miratojmë dhe të rregullojmë bazën ligjore apo mos e miratojmë fare?

**Plator Çollaku:** Ne nuk e rregullojmë dot bazën ligjore se ajo është përcaktuar nga Parlamenti, por ne mund të shohim një hapësirë ligjore në mënyrë që këto familje të ndihmohen. Formulimi i P-V duhet të jetë ndryshe.

**Ornildi Demollari:** E kuptova Plator, faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër?  
Po Ildir.

**Idlir Limllari:** Kryetar, specialistët që formulojnë këto të shtojnë dhe diçka tjetër, jo vetëm dengje, personit i janë bërë më shumë dëme. Në këtë formë abuzohet, me sa pamë në procesverbal atij i janë djegur dhe gjëra të tjera, probelmi është formulimi jo shuma.

**Ornildi Demollari:** Po Ildir e qartë, ka ndonjë koment tjetër? Ju ftoj ta miratojmë dhe pastaj të shikohet baza ligjore.

Z.Kryetar jemi te P-V me nr.5 “Për dhënie ndihme financiare” ky P-V ka ardhur njëherë në Këshill dhe ne e kemi kthyer për shkak se nuk është formuluar mirë, është pasqyruar e gjithë vlera e dëmit, kur ne kemi të drejtë të kompesojmë vetëm 50% të vlerës. P-V ka ardhur përsëri kështu.

**Pranvera Begolli:** Kryetar e kthjem se baza ligjore nuk ishte e rregullt, kishin vendosur ligjin aktual dhe më pas VKM-në, pastaj hymë në hollësira të dëmit. Askush nga ne nuk e vërteton dot që u dogjën kaq dengje kashtë.

**File Qyrani:** Ne diskutojmë kot se po të shohim vlerën e tregut për dengje, ne 50% i japim personit të vlerës. Komisoni e ka mirë formulimin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Plator Collaku:** Prefektura duhet ta kuptojë që ne po japim 50% të vlerës.

**Valentina Pashollari:** Debati po bëhet për formulimin e P-V që ata nuk kanë ndryshuar asgjë.

**Ornildi Demollari:** Ju ftoj ta votojmë dhe P-V të riformulohet.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Përsëritje të gjithëve! Do doja ta mirojmë si P-V dhe më pas të shihet baza ligjore për % që ne kemi detyrim ligjor për të paguar, kaq mund të them për momenti se duhet ta verifikoj të gjithën si praktikë, se duhet të jem i sinqertë jo vetëm me ju por dhe me qytetarët, por dua rregullshmëri në zbatimin e vendimmarrjeve të akteve ligjore të punonjësve të administratës që unë kam, në çdo rast nuk do të thotë që Kryetari i Bashkisë mund t'i dijë të gjitha, prandaj dua të bëj një verifikim të jem konsistent edhe me ju dhe qytetarët por dhe me familjen në fjalë, e cila n.q.s. ligji e parashikon që e merr të tillë dhe unë do ja bëj prezent menjëherë.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim P-V me nr.5?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim? Ildir Limllari 1.

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 22 vota pro.

Kalojmë te pika e 6 rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Arif Myftarago, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit". Jemi në një rast të ngjashëm me të parin, ka ndonjë koment?

**Pranvera Begolli:** Për këtë nuk kemi çfarë të komentojmë e thashë dhe më parë, sepse orenditë mbeten pas zjarrit dhe janë të evidentueshme kollaj, kështu që unë them ta miratojmë Projekt-Vendimin, ne vemë në një P-V dengje, kashtë dhe jonxhë dhe mirë e ka Filja që vlera është aq dhe japim 92.500 dhe ky që i ka orendi dhe pajisje i japim 82.000 lekë.

**Valentina Pashollari:** Dhe te ky P-V ashtu është shënuar vlera e plotë, duhet të shihet ligji dhe të sitemohet edhe këtu.

**Pranvera Begolli:** Te P-V i parë nuk është vendosur VKM-ja nr.329, te P-V po!

**Ornildi Demollari:** Stiljam pse P-V është sjellë përsëri ashtu si ishte?

**Përgjegjës i Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta:** Do diskutojmë rastin e parë apo të dytë?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Ajo çfarë këshilltarët duan të dinë, është në fuqi përcaktimi që ne japim deri 50% të vlerës.

**Përgjegjës i Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta:** Faleminderit Kryetar! Do jap shpjegimet përkatse, ne funksionojmë ligjin nr.45/19 Për Mbrojtjen Civile dhe ligjit i mungon VKM-ja specifike për vlersimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, neni 43 i ligjit thotë që deri në momentin që do dalë një VKM-ja e re për procedurën e vlerësimit të dëmeve do të jetë në fuqi VKM-ja nr.329 e viti 2012.

Po ky ligj citon në pikën e fundit të tij që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 45/19 shfuqizohet ligji i vjetër, m.q.s. këshilltarja znj.Vera ka edhe një ngërç në pjesën e vlesërimit pse bëhet në mënyrë totale dhe jo 50% dua t'i sqaroj dhe njëherë, dua të citoj VKM-në ku thuhet se vlerësimi në vlerën 50% bëhet për dëme ndërtimore dhe jo elektroshtëpiake, vlerësimi ndahet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

në dy momente, vlerësimi i parë është ai në orendi shtëpiake që bëhet 100% dhe vlerësimi në dëme materiale, kur supozojmë së 1 milion lekë do marrim vlerën 50% të tij.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Kam një propozim Kryetar, të gjitha vendimmarjen duhet të kalojnë nga zyra Jurdike, po shoh P-V këtu nuk e kanë ciklimin e zyrës Jurdike, t'i kalojmë në parim të rregullohet baza ligjore dhe jurdike dhe të jemi në rregull edhe me ligjin, dhe me ju, dhe me qytetarët.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë koment tjetër?

E kalojmë në votim? Me kushtin të shikohet nga zyra Jurdike?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika e 7 rendit të ditës, P-V "Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e pllakadës përkujtimore në vendin e quajtur "Kthesa e Pocestës" në përkujtim të të dënuarve me punë të detyruar për tharjen e kënetës së Maliqit";

**Pranvera Begolli:** Përhëndetje Kryetar! Do më kujtoni sikur jam nostalgjke për kohën e kaluar, por aktualisht ajo pllakadë përkujtimore vendoset për punëtorët me punë të detyruar jam dakord, por nëse vendoset për ata që ne i quanim sabotatorë të tharjes së kënetës nuk jam dakord, po e ndryshojmë hitorinë e popullit shqiptar, po dekorojmë kriminelë, dhe gjithë populli i Maliqit do ma miratojë çfarë po them.

**Ornildi Demollari:** Z.Kryetar!

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Në fakt indicja nuk është nga ne si bashki, por është nga Autoriteti i Informimit për Dokumnetat e ish-Sigurimit të Shtetit, të cilët kanë bërë dhe një takim këtu, ata janë institucion shtetëror në vartësi direkt nga Parlamenti, ndoshta këshilltarët kanë të drejtë për informacion dhe ndoshta mund t'i takojë dhe një mbledhje e radhës të plotësohet n.q.s. ju e shihni të arsyeshme për se bëhet fjalë dhe të vendosi.

Edhe pse ka një miratim në parim duhet parë ku është vendi, pronë private apo shtetërore, për vendosjen e saj do ketë dhe një lejë pas miratimit që do bëjë këshilli i bashkisë, po ju me të drejtë duhet të dini pse bëhet fjalë saktësisht dhe besoj se shkresa sa mund t'ju japë të drejtën për ta miratuar, shkresa që ka ardhura nga Autoriteti i Informimit për Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit që është një institucion ligjor në vartësi të Parlamentit.

**Pranvera Begolli:** Ju falenderoj Kryetar! Por është drejta e këshilltarëve të njhen me atë material, të nderuarit e Autoritetit të vijmë të na sqarojnë dhe të bindin që vërtet ata e meritojnë atë përmendore të kthesa e Pocestës. Nuk jam dakord të miratohet, të rishikohet edhe njëherë.

**Ornildi Demollari:** Me materialet jemi njohur në mbledhjet e kaluara Pranvera. Nëse pret mund ta shtyjmë?

**File Qyrani:** Mos ka nevojë dhe për një konsultim publik?

**Pranvera Begolli:** Të bëhet konsultim publik me gjithë organizatat dhe qytetarët e tjerë dhe ta miratojmë.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Nuk duhet të jemi emocionalë as ne as ata, duhet të jemi të ftohtë në vlerësimin e historisë, por me të drejtën që ju jep ligji dhe ju keni të drejtë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

informoheni për se bëhet fjalë, se do të merret një vendim i cili duhet t'i rezistojë edhe kohës. Ne kemi bërë këtu një konferencë për këtë qëllim, ato që ka sjellë e Autoriteti me dokumentacion kanë bërë dhe një libër, por këshilltarët duhet ta kenë këtë informacion n.q.s. nuk e kanë dhe mund të mblidheni më vetë për ta diskutuar.

**Ornildi Demollari:** Z.Kryetar do të donim nga ana juaj ka kohë për vendimin?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Ne nuk mund të marrim vendim apriori! Ne shumë shpejt do kemi mbledhje jashtë radhe për buxhetin shtesë për një javë. Brenda kësaj jave sekretari i këshillit dhe Përgjegjës sektori i Trashëgimisë Kulturore të rakordojë me me institucionin, të dërgojnë një përfaqësues dhe të sqarojë disa momente pse bëhet fjalë, n.q.s. kjo ka nevojë për diskutim publik këtë duhet ta ndajë këshilli ku kanalizohet, ndoshta dhe zyra Juridike dhe ne, ku hyn kjo si temë e prekshme apo jo. Të jemi korrekt dhe me ata që na dëgjojnë, pasi qëllimi është që çdo vendimarrje t'i rezistojë kohës, jo voto sot dhe hiq nesër, apo krijo problematika të tjera, duhet parë me kujdes.

**Ornildi Demollari:** I kërkoj këshillit që pikën 7, P-V Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e pllakadës përkujtimore në vendin e quajtur "Kthesa e Pocestës" në përkujtim të të dënuarve me punë të detyruar për tharjen e kënetës së Maliqit" mos e marrim në shqyrtim dhe të ngarkohet Sekretari i Këshillit së bashku me Komisionin e kulturës pranë këshillit dhe me gjithë strukturat për ta studiuar më mirë këtë material dhe në një mbledhje të radhës, ku të pajisemi me material të detajuar ta marrim në shqyrtim. Jemi dakord?

Kalojmë te pika e 8 rendit të ditës, P-V "Për dhënien e miratimit të lidhjes së kontratës të huapërdorjes për pasurinë me nr.3/590, volumi 10, faqe 138, zona kadastrale 2573, midis Bashkisë Maliq dhe Zyrës Arsimore Vendore Maliq";

**Pranvera Begolli:** Unë them ta miratojmë P-V, nuk kemi çfarë të diskutojmë sepse e kemi kaluar më parë.

**Ornildi Demollari:** Këtë herë kemi dhe Plan-Vendosjen, ju ftoj ta miratojmë P-V, nëse nuk ka ndonjë pyetje ose koment? Kolegët që na ndjekin nga online?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika e 9 rendit të ditës, P-V "Për miratimin e bursave të arsimit parauniversitar dhe profesional të vitit shkollor 2021-2022";

**Pranvera Begolli:** E kalojmë në miratim, po janë plotësuar të gjitha kërkesat? E kalojmë në miratim.

**Ornildi Demollari:** Ka ndonjë koment?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Te rendi i ditës kemi 9 pika të pasqyruara, por kemi rënë dakord të shyrtojmë edhe disa pika të tjera me motivacionin që këto P-V mos ngelen për mbledhjen e ardhshme dhe për pasojë të pengohet puna. Do t'ju kërkoj që t'i marrim në shqyrtim dhe t'i miratojmë pse jo.

P-V tjetër që do mbajë nr.10 është "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.94 datë vendimin nr.94 datë 24.12.2021" kush e do fjalën, Kryetar?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** P-V ka dy momente, një momente është njehsimi i pagave për dy inxhierët e mekanikës në 40.000 lekë, momenti i dytë ka të bëjë me marrjen e strukturës që ne kemi në stadiume siç janë kujdestarë të stadiumeve Maliq, Pirq dhe Pojan, pasi ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë statusin për Klubin e Futbollit që ne e kemi nxjerrë në shitje dhe n.q.s. shitet jemi në rregull dhe nëse nuk shitet do kalojmë në një formë tjetër shoqate, na takon ne të mbajmë nën kontroll objektet që janë pronë e bashkisë, si dhomat e ndërrimit, stadiumet të cilat i shërbejnë jo vetëm Klubit të Futbollit, por edhe ekipeve të ndryshme në Maliq, Pojan, Pirq, prandaj do deshëm që këto 4 pozicione të kalojnë te Shërbimi Publik për efekt të sportit dhe zgjidhim dhe ngërçin që mund të kishim me këta punonjës nga data 1 janar e në vazhdim, kaq ka P-V.

**Pranvera Begolli:** Faleminderit Kryetar! Më vjen mirë që barazohen pagat e dy njerëzve që bëjnë punë të barabarta të marrin pagë njëlloj. Kam vetëm diçka kur kemi diskutuar që futboili do kalojë për shitje te asetet do përfshihet dhe stadiumi?

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Asetet nuk shiten. Jepen në përdorim, as emri nuk shiten.

**Pranvera Begolli:** Faleminderit! Jam dakord ta miratojmë.

**Ornildi Demollari:** Ka ndonjë pyetje tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te P-V i radhës i cili do mbajë nr.11 P-V "Për një shtesë në vendimin e këshilli me nr.95 datë.24.12.2021" është fjala për një shtesë fondi.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Kemi miratuar në mbledhjen e parë të Këshillit të Bashkisë tre objekte me efektet financiare tre vejeçare. Është hera e parë që ne zbatojmë një praktikë të tillë, pasi në varësi të problematikave janë disa objekte që kërkojnë një vlerë financiare të shtrirë në kohë, në kuptimin për ta realizuar dhe për mos rënduar shpenzime apo investime të tjera shumë të domosdoshme që ndodhin rast pas rasti.

Do kërkoja nga Këshilli dhe miratimin për dy objekte të tjera pavarësisht se ju kemi sjell një P-V këtu. Nga përllongartija që kemi bërë për efekt të pjesës ndërtimore të Pallatit të Kulturës ajo shkon në këto nivle, prandaj ju kemi kërkuar dhe më këtë fond ne synojmë të mbyllim pjesën ndërtimore të Pallatit të Kulturës, nga çatia dhe gjithë fasada dhe gjithë pjesa që përfshin betonet dhe pjesa e hekurit, që do të thotë që ne sigurojmë një bazamet të sigurtë dhe shpëtojmë atë objekt. Dhe në këtë pikë unë them që ne si organ i pushteti lokal duhet të sakrifikojmë dhe duke rënuar pak buxhetin ndër vite, pavarësisht se ai do detajohet dhe do jem dakord që në prokurim apo dhe në zbatim të jetë i shtrirë në kohë dhe momenti i dytë që unë propozoj që nuk e kenë në P-V, llogaritja që kemi bërëshkon nga 40 që e kishit herën e parë shon në 50 milion pas rakordimit që bëmë me studion e projektimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Dhe ajo çfarë dua tju bëj me dije se jemi në negociata me FSHZH për të bërë ata pjesën e dytë, shpresoj që ky objekt brenda vitit që jemi apo marsi ose prilli i vitit tjetër të jetë i përfunduar nga Qeveria Shqiptare.

E dyta që do kërkoja që për rrugët në njësitë administrative të shtoja dhe 20 milion lekë të tjera të ndarë nga 10 milion në 2023 dhe 2024, të përfshijmë në këtë linjë një pjesë të rrugëve kryesore të cilat normalisht duhet t'i prokurojmë sa më parë, dhe kjo është një shtesë që ja u kërkoj sot. Nqs kemi pasur një objekt me 70 milion lekë të ndarë në tre vjet shkojmë në vlerën 90 milion, ku përfshihen të gjitha njësitë administrative me rrugët kryesore, këtu nuk hyn pjesa e Maliqit që ka një fond në buxhet zë me vete.

Do doja miratimi të këshilltarve në sallë dhe atyre online dhe ndoshta në një moment të caktuar, në mbledhjen e radhës do ju sjell një informacion për rrugët të cilat do përfshihen te ky P-V, që do i japë një zhvillim të madh transportit të mjeteve, etj.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar! E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro, me shtesën që prezantoi Kryetari.

Faleminderit!

Na kanë ardhur dhe dy materiale të tjera në fakt, të cilat do t'ju lutesh t'i marrim në shqyrtim P-V "Për vlerësimet afatmesme të të ardhurave 2023-2025"

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Kjo është një procedurë standarde dhe nuk e di pse i vonojnë! Nuk ka efekte financiare është një procedurë ligjore.

**Ornildi Demollari:** Sot e solli Drejtoria e Financës, do t'ju ftoj ta miratojmë, ka pyetje? P-V "Për vlerësimet afatmesme të të ardhurave 2023-2025"

**Pranvera Begolli:** Ne jemi të detyruar ta miratojmë, sa ka të bëjë me një buxhetim, por i lutem Kryetarit të Bashkisë që administrata të jetë me korrkete me materialet.

**Ornildi Demollari:** E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Kemi dhe dy P-V që kanë të bëjnë me Klubin e Futbollit të cilat dhe këto erdhën së fundmi.

P-V "Për shlyerjen e detyrimeve të Klubit të Futbollit Maliq sh.a" dhe P-V "Për themelimin e Shoqatës Sportive".

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Nga janari ne nuk mund të paguajmë më apo Sh.a nuk mund të paguajë me paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit, që të jemi ne korrekt me Sh.a-në, duhet të shlyejmë detyrimet e prapambetura, të cilat kemi ndaj Sh.a-së për vitin 2021, ashtu si mbyllim detyrime për investime të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe këtu. Të jetë ok dhe Drejtoria e Financës që mos jetë shkelje që ju dhe në janar keni pagaur paga, po paguajmë pagat e dhjetorit dhe gjithë shpenzimet që mund të ketë Këshilli Mbikëqyrës, etj. Dhe Drejtoria Juridike me P-V e dytë të eci paralel edhe me shitjen dhe krijimin e Shoqatës së Futbollit ashtu si ligji e jep. Që të jemi në rregull me zhvillimin normal të futbollit dhe nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

I janari t'ju themi këto lekë ja u kemi dhënë për ushqim, transport apo dieta ashtu si e parashikon ligji. Po gjetën privat për t'ju pagaur pagat do jetë pozitive, po mos gjetën do vazhdojmë në këtë linjë.

**Pranvera Begolli:** Nuk jemi me atë që mos e miratojmë P-V sa ata natyrisht na justifikojnë, por problemi është që materiali të ishte vënë në dispozicion pesë ditë para. Kemi miratuar shtatë P-V jashtë radhe.

**Ornildi Demollari:** I ftoj këshilltarët t'i shqyrtojmë dhe t'i miratojmë P-V, P-V "Për shlyerjen e detyrimeve të Klubit të Futbollit Maliq sh.a" dhe P-V "Për themelimin e Shoqatës Sportive".

I kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro P-V i cili do mbajë nr.13. Faleminderit!

Dhe e fundit P-V "Për krijimin e Shoqatës Sportive jo-ftimpruese dhe miratimin e Aktit të Themlimit dhe Statutin"

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Këshilli na jep të drejtën që të regjistrohemi në gjykatë.

**Pranvera Begolli:** Në mbledhjen jashtë radhe që do kemi të bëjmë dhe miratimin projekt programit për vitin 2022 të Kombinati të Sheqerit dhe e dyta e kam me Krytarin e Bashkisë disa familje kanë probleme me ujërat e zeza në Maliq.

**Ornildi Demollari:** Kemi një qytetare që ka një problem ta dëgjojmë.

**Qytetarja:** Kam një fëmijë të sëmurë, ka probeleme me shtyllën kurizore, e gjetëm doktorin që do bëjë opeacionin, por kushton shumë opeacioni, ju kërkoj ndonjë ndihmë, operacioni kushton 15 mijë euro.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Kemi dhe disa raste të tjera të kësaj natyre edhe ajo që mund t'ju them është nuk mbulojmë shpenzime për operacione se nuk lejon ligji. Por ne mund të mbulojmë shpenzime të vogla, dorëzo te Azemi disa dokumeta dhe besoj me Këshillin do shikojmë. Do shikojmë mundësinë maksimale çfarë mund të bëjmë në mbledhjen e radhës. Ndoshta mund të jetë dhe një sensibilizim për aktorë të tjerë që mund të kontribuojnë për këtë rast edhe nga shoqata të ndryshme dhe Platori mund të na orjentojë. Fondi jonë është 10 milion lekë.

**Plator Çollaku:** Dhe për organizata si jona kjo është një shumë e madhe, por duhet patur parasysh se ka disa fondacione që operojnë në zonë të përfshihet një grup më i madh se dhe shumta është e konsiderueshme.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Ajo çfarë unë propozoj dhe të falenderoj që ndërhyre, është që ne të ndihmojmë me sa të kemi mundësi, të bëjmë një sensibilizim për të mbuluar një pjesë të shumës.

**Ornildi Demollari:** Mbledhja mund të jetë shumë shpejt, mund të largohesh tani me Azemin. Genci një shpjegim për P-V "Për krijimin e shoqatës sportive jo-ftimpruese dhe miratimin e Aktit të Themlimit dhe Statutin" doli problemi që kjo mos duhet shqyrtuar si fillim te Asambleja e Klubit?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimve Genci Floqi:** Asambleja e Klubit të Futbollit merr vendime për Sh.a, kurse për shoqatën merr Këshilli i Bashkisë.

**Pranvera Begolli:** Shpjegojeni mirë që po krijohet shoqatë e re.

**Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:** Ne e kemi nxjerë Sh.a-në e Futbollit në shitje dhe për të fituar në kohë të bllokimit nga ligji, n.q.s. ajo nuk shitet po ecim ne dy linja, për ta kthyer nga Sh.a në shoqatë, është një organizim i ri. Edhe nëqoftë se kjo Sh.a nuk shitet ligji na detyron ta kalojmë në shoqatë.

**Ornildi Demollari:** Nëse nuk kemi gjë tjetër ju ftoj ta votojmë P-V,

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 11 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 23 vota pro. Faleminderit!

Këto ishin pikat, nëse kemi ndonjë gjë tjetër? Ky ishte rendi i ditës këto ishin pikat për këtë mbledhje, ju falenderoj!

Mbledhja mbyllet!

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**

